

Standardet Globale për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës

2020

REZOLUTA U ADAPTUA NGA ASAMBLEJA E 6-TË E PËRGJITHSHME E KËSHILLIT NDËRKOMBËTAR TË REHABILITIMIT TË VIKTIMAVE TË TORTURËS (IRCT) ME 06 TETOR 2020.

Ta njohësh se ekziston një vazhdimësi e standardeve të shërbimeve të rehabilitimit dhe se ato mund të ndryshojnë në çfarëdo kohe, në varësi të kontekstit, të situatës politike dhe shkallës së shkeljeve të drejtave të njeriut;

Të ngrisim përpjekjet tona t'a parandalojmë torturën, të luftojmë mosndëshkimin dhe të ofrojmë korrigjimin dhe qasjen holistike të rehabilitimit të viktimave;

Anëtarët e Këshillit Ndërkombëtar të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës (IRCT), në punën e përbashkët për identifikimin, krijimin dhe promovimin e standardeve minimale për realizimin e programeve rehabilituese me qasje holistike, duam t'iu dedikohemi personalisht dhe të nxisim të gjithë ofruesit e shërbimeve rehabilituese të:

Paragrafi 1 – Përkushtimi ynë ndaj viktimave:

Të mbështesin mirëqenien dhe dinjitetin e viktimave¹ të torturës² si dhe standardet profesionale dhe principet etike të ndërlidhura me trajtimin dhe rehabilitimin, duke përfshirë pëlqimin e informuar, konfidencialitetin, parimin e të mos bërit dëm, zgjedhjen e interesit më të mirë të viktimave si dhe zgjedhjen e tyre të lirë rreth shërbimeve që i pranojnë,

¹ IRCT-ja nënvizon që disa akterë anti-torturës preferojnë të përdorin terminologji alternative nga fjala “viktimë” në të tilla si “të mbijetuar” ose “person-subjekt i torturës”. Për qëllime të qartësisë dhe konsistencës ky dokument do ta përdori termin “viktimë” të përshkruajë cilindo person që ka qenë subjekt i torturës apo të trajtimeve mizore, johumane, trajtimeve degraduese apo ndëshkimit.

² Në këtë dokument, termi “torturë” i nënkupton të gjitha veprat të cilat mund të klasifikohen si “torturuese” ose “mizore, johumane apo trajtim degradues dhe ndëshkimor”, siç janë të definuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës.

rezistimin e ri-traumatizimit si dhe zbatimin e praktikave globale më të mira, të cilat janë të gjitha shumë të rëndësishme për rehabilitimin e qendrave të cilat janë ta pavarura dhe të përgjegjshme ndaj viktimave, në harmoni me principet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara (UN) kundër Torturës – në komentin e përgjithshëm nr.3 në të drejtën për korrigjim dhe rehabilitim.

Paragrafi 2 - Shërbimet e Pavarura:

Implementimi i strukturave relevante si dhe procedurave në mënyrë që rehabilitimi të mund të ofrohet në mënyrë të pavarur, autonome, si dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet profesionale dhe etike, të lirë nga çfarëdo ndikimi të jashtëm. Në veçanti qendrat e rehabilitimit duhet ta prioritulojnë zhvillimin dhe implementimin e strukturave, metodologjive dhe procedurave që janë me qendër-viktimën, të bazuara në evidencë, pjesëmarrëse, fuqizuese, holistike, të qasshme, të drejta, të respektueshme, sensitive ndaj gjinisë, kulturalisht të përshtatshme dhe të përgjegjshme. Atëherë kur fondet merren nga burime të cilat mund të perceptohen sikur e vendosin një ndikim të jashtëm në ofruesin e shërbimeve të rehabilitimit, është esenciale të sigurohet që mandati i organizatës dhe principet e konfidencialitetit të viktimës, transparenca dhe pavarësia në vendim-marrje janë të prioritetuara dhe theksojnë interesin më të mirë të viktimave. Viktimat e torturës duhet të informohen në lidhje me masat që ndërmerren të mbrohet procesi i rehabilitimit nga ndikimet e jashtme.

Paragrafi 3 – Siguria e Viktimave:

Sigurojeni implementimin e të gjitha masave të mundshme të sigurisë dhe ruajtjes së viktimave që marrin shërbime të rehabilitimit duke përfshirë të gjitha aspektet e raporteve me viktimën, duke pasqyruar interesin më të mirë të viktimave të torturës si një princip çelës në shërbimet e rehabilitimit. Viktimat e torturës duhet të informohen për dhe të ofrojnë të dhëna në përcaktimin e masave mbrojtëse dhe të sigurisë.

Paragrafi 4 – Mbështetja e Familjeve:

Sigurohuni që nevojat specifike të rehabilitimit të familjarëve të viktimave të torturës, në veçanti të fëmijëve dhe popullatave të cënueshme, konsiderohen një pjesë qendrore e procesit të rehabilitimit. Atëherë kur burimet e lejojnë, familjet duhet të pranojnë mbështetje në harmoni me nevojat e tyre. Atëherë kur është relevante dhe kulturalisht e përshtatshme qasjet me bazë në komunitet duhet të implementohen gjatë procesit të rehabilitimit.

Paragrafi 5 – Qasja në Drejtësi:

Kurdo që është e mundur, duhet të ofrohet mbështetja e viktimave t'i qasen drejtësisë dhe të jenë avokues për eliminimin e torturës si pjesë e procesit të rehabilitimit. Kjo përfshinë mbështetjen e viktimave të dokumentojnë deklaratat e tyre në harmoni me Protokollin e Stambollit³ dhe të ngrejnë padi si dhe të avokojnë te autoritetet locale, të adoptojnë dhe implementojnë ligje nacionale kundër torturës si dhe të ndërtojnë Mekanizma Nacional të Parandalimit të Torturës.

Paragrafi 6 – Procesi i Marrjes së të Dhënave:

Krijoni procese të marrjes së të dhënave përmes së cilave viktimat e torturës mund të kenë qasje në shërbimet e rehabilitimit në baza të vet-referimit apo referimit nga një palë e tretë, të tilla si nga profesionistët kompetentë të fiziologjisë, shëndetit mendor, social apo ligjor; mbrojtësit e të drejtave të njeriut; mbrojtësit e të drejtave religjioze, të drejtave të popullatave autoktone, të karakteristikave etnike apo grupeve minoritare; apo të mbijetuar të formave të tjera të torturës dhe familjarëve të tyre. Këto procese duhet të sigurojnë që, brenda resurseve të qasshme, viktimat e torturës të kenë qasje pagesë, të barabartë dhe jo-diskriminuese në shërbime, pavarësisht mundësisë së tyre të paguajnë apo të statusit së tyre ligjor në vendin në fjalë. Deri në masën sa është e mundur, ofruesit e shërbimeve rehabilituese duhet të priorizojnë shtrirjen e tyre në veçanti për viktimat e torturës të cilët janë të marginalizuar, të privuar nga liria, të cilët jetojnë në zona të largëta apo të cilëve ju mungojnë fondet për mbulimin e shpenzimeve të rrugëtimit.

Paragrafi 7 – Qasja në Informacion:

Ofroni viktimave të torturës të gjitha informatat relevante që ndërlidhen me shërbimet rehabilituese të cilat janë në dispozicion. Qendrat e rehabilitimit duhet të respektojnë dhe të promovojnë viktimat e torturës të jenë agjentë të jetës së tyre si dhe të zgjedhjeve të tyre sa i përket rehabilitimit. Atëherë kur është e mundur dhe e përshtatshme për ofrimin e shërbimeve, duhet të vihen në dispozicion përkthyes kredibil, pa shpenzime financiare nga ana e viktimës. Kurdo që është e mundur, viktimat duhet t'a kenë në dispozicion mundësinë e zgjedhjes së gjinisë së personit që ofron shërbimin profesional rehabilitues, duke përfshirë përkthyesit. Pëlqimi i informuar duhet dhënë në harmoni me standardet relevante profesionale dhe parimet etike para dhe pas procesit të rehabilitimit.

³ Manual për Hetimin dhe Dokumentimin e Torturës si dhe formave të tjera të ushtrimit të mizorisë, trajtimin degradues dhe jonjerëzor apo ndëshkimit

Paragrafi 8 – Përshtypjet e Viktimës:

Vendosni procedura dhe mekanizma të cilat ua mundësojnë viktimave të torturës të ofrojnë përshtypje (feedback) të vazhdueshëm, përfshirë përfundimin apo tërheqjen nga programet rehabilituese, në gjuhën të cilën e flasin, rreth shërbimeve të cilat i marrin; për shembull, përmes përdorimit të mekanizmave fizik të angazhimit të përdoruesve (të tilla si “kutitë e ankesave”⁴), pyetësorët e matjes së kënaqësisë së të mbijetuarëve me shërbimet, forma të vlerësimit të shërbimeve, grupe të fokusit si dhe mekanizma të tjerë të vlerësimit të pjesëmarrjes. Ky regjistrim i përshtypjes duhet të vlerësohet në mënyrë periodike dhe ta formojë bazën për përmirësime të vazhdueshme të shërbimeve rehabilituese të cilat ofrohen. Shkalla e kënaqshmërisë duhet të definohet qartë si dhe të përdoren standarde të aplikuara në vazhdimësi. Për më tepër, duhet të ndërtohen mekanizma përmes së cilave të mbijetuarit mund të ankohen dhe të marrin përgjigje të shpejtë dhe të kënaqshme në raport me shërbimet rehabilituese të cilat i marrin. Viktimave duhet t’iu mundësohet përfshirja efektive përmes masave të tilla si ofrimi i informacionit për mundëistë e ankimit si dhe vendosjes së funksioneve mbështetëse që përfshijnë edhe të mbijetuar të tjerë.

Paragrafi 9 – Pjesëmarrja e Viktimave në Procesin e Rehabilitimit:

Promovoni kontributet kuptimplota të viktimave në dizajnimin e shërbimeve dhe zbatimin e tyre, në hulumtim, në vendim-marrje si dhe procesit të udhëheqjes së shërbimeve të rehabilitimit përmes njohjes së përjetimeve të viktimave në zhvillimin e programeve të shërbimit si dhe procesit të rekrutimit, të hapen proceset e këshillimit dhe përshtypjeve si dhe metodave të tjera të përfshirjes të cilat janë të përshtatshme për kontekstin dhe situatën.

Paragrafi 10 – Kapaciteti Organizativ:

Prioritizoni trajnimin e vazhdueshëm dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe vullnetarëve, për shembull, në metoda të specializuara të trajtimit të bazuara në evidencë; në teknika të intervistimit sensitive ndaj traumës; të dëgjuarit empatik dhe antiracizmin; ngritjen e vetëdijes mbi çështje kulturore dhe gjinore në harmoni me standardet relevante profesionale; mbi standardet ndërkombëtare etike dhe të të drejtave të njeriut.

⁴ Shënim i përkthyesit.

Paragrafi 11 – Siguria e Stafit:

Sigurohuni që ekipi dhe vullnetarët janë të sigurtë, jeni përkujdesur për 'ta, janë të siguruar dhe që i keni mjetet apo mënyrat për t'i adresuar incidentet të cilat do të mund t'a kompromentonin sigurinë e tyre apo sigurinë e të tjerëve duke raportuar proceset apo përmes mënyrave të tjera edhe më të përshtatshme përmes së cilave sigurohet që këto rreziqe janë të dokumentuara dhe që masat të përshtatura me kontekstin janë ndërmarrë për t'i minimizuar ato. Në këtë sens, qendrat e rehabilitimit duhet të sigurojnë adaptimin dhe implementimin e politikave të përshtatshme për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit, ngacmimit dhe të dhunës seksuale, si dhe formave të tjera të abuzimit.

Paragrafi 12 – Kujdesi ndaj Stafit:

Adresoni traumën e bartur dhe parandalimin e djegies profesionale si një prioritet i organizatës për të gjithë stafin. Për këtë qëllim, siguroni një infrastrukturë të fuqishme dhe mbështetëse për mirëqenien dhe ambientin e punës së ekipit përmes për shembull, supervizimit të rregullt, grupeve të mbështetjes së kolegëve, mentorimi i ekipit/ekipeve, zbatimin e teknikave të mbështetjes psikosociale dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në punë.

Paragrafi 13 – Këmbeni Njohuritë:

Përhapeni informacionin mbi torturën dhe efektet e saj, nëpër grupet e profesionistëve shëndetësor apo të fushave të tjera relevante të cilët mund të vijnë në kontakt me viktimat e torturës. Informacioni duhet të përfshijë qasje të gatshme dhe të mundura për rehabilitimin, me të dhëna për nevojat specifike për viktimat e torturës (duke përfshirë identifikimin e hershëm, vlerësimin dhe referimin me kohë), kujdesin e mirë-informuar për traumën, procedurat e dokumentimit sipas Protokollit të Stambollit dhe ndërlidhjen me vlerat e ofrimit të rehabilitimit për të lehtësuar jetën pas torturës. Atëherë kur e lejon vlerësimi i sigurisë, shpërndarja e këtij informacioni duhet të konsiderohet një përgjegjësi kritike morale dhe sociale për qendrat të cilat i asistojnë viktimat e torturës.


Paragrafi 14 – Avokoni për Fonde të Rehabilitimit:

Aplikoni vegla të vlerësimit të cilat janë të duhura për kontekstin e dhënë specifik. Kjo bëhet me njohjen që anëtarët e IRCT-së ofrojnë shërbime në kontekste shumë të ndryshme, duke përfshirë qendrat e mbajtjes, opresionin politik, viktimat me status të pazgjidhur, diskriminimin dhe varfërinë, të cilat mund të kenë një efekt negativ në kualitetin e jetës së viktimës. Për më tepër, secila qendër anëtare do të vendos se cilat vegla janë më së miri të përshtatura për

përdorim të vlerësimit të përmirësimeve në të gjithë indikatorët relevant për të adresuar nevojat dhe për të përmirësuar kualitetin e jetës së viktimave të torturës të cilët i mbështesin si dhe t'a komunikojë këtë në anëtarësinë e IRCT-së. Në dokumentimin e rezultateve të punës së tyre, anëtarët e IRCT-së inkurajohen të marrin parasysh se si kualiteti i jetës së viktimave të torturës ndërlidhet me zotërimin e të drejtave, duke përfshirë qasjen në drejtësi, mbrojtjen ndërkombëtare, korrigjimin dhe përvetësimin e të pesë formave të dëmshpërblimit (rikuperimit, kompensimit, rehabilitimit, të qenit i/e kënaqur dhe e drejta për të vërtetën dhe garantimi i mos-përsëritjes).

Paragrafi 17 – Dokumentimi i Ndikimit Global:

Ndani rezultatet e mbështetjes së viktimave të torturës me anëtarët e IRCT-së në baza vjetore. Kjo do të bëhet pjesë e Raportit Vjetor të Impaktit të IRCT-së, i cili ia demonstroi botës ndikimin tonë kolektiv në jetën e viktimave të torturës.

	Për më shumë informata ju lutem vizitoni: www.irct.org	Vesterbrogade 149, building 4, 3 rd floor 1620 Copenhaen V Denmark
---	--	---

